



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**



Promovimi i punësimit në sektorin privat  
(*ang. Promoting private sector employment*)

PPSE - Kosovë

Raporti gjashtëmuor (RGJ) 2019

1 Janar 2019 - 30 Qershor 2019

Prishtinë

Në bashkëpunim me:



## Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
1. Informatat themelore .....	5
2. Përmbledhje ekzekutive.....	6
3. Raportimi i arritjes së rezultateve	7
3.1. Ndikimi .....	7
3.2. Rezultati 1 .....	9
3.3. Rezultati 2 .....	15
3.4. Fondi i mundësive .....	21
3.5. Fondi për përfshirjen sociale (ang. Social Inclusion Fund).....	23
4. Temat transversale .....	24
4.1. Përfshirja Sociale.....	24
4.2. Gjinia .....	24
5. Konsulenca .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6. Financat.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.1. Buxheti .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7. Organizimi i projektit, menaxhimi dhe drejtimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.1. Ngritja e kapaciteteve dhe shkëmbimet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2. Organizimi dhe menaxhimi i projektit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2.1. Drejtuesit e projektit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2.2. Monitorimi dhe Matja e Rezultateve.....	25
7.3. Komunikimi .....	26
8. Mësimet e nxjerra .....	27

## Lista e shkurtesave

BMO	Organizatë e anëtarësimit të biznesit
CEED	Qendra për edukim dhe zhvillim të ndërmarrësisë
CHF	Franga zvicerane
DCED	Komiteti i donatorëve për zhvillimin e ndërmarrjeve
ENE	Ekonomia dhe punësimi
EU	Bashkimi Evropian
EYE	Rritja e punësimit të të rinjve
FAMtrip	Udhëtime të familjarizimit
FGD	Diskutim në grupe të fokusuara
FTE	Punësim me orar të plotë
FNI	Ushqimi dhe përbërësit natyral
FVA	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
G.A.P.	Praktikat e mira bujqësore
GDP	Bruto prodhimi vendor
HO	Zyra qendrore
IADK	Nisma për zhvillimin bujqësor të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KEA	Agjencia e Punësimit e Kosovës
KCC	Oda Ekonomike e Kosovës
KIESA	Agjencia Kosovare e Investimeve dhe Përkrahjes së Ndërmarrjeve
KMC	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
KSA	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KWCC	Oda Ekonomike e Grave të Kosovës
MAFRD	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MAP	Bimët medicinale aromatike
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MRM	Monitorimi dhe matja e rezultateve
MSD	Zhvillimi i sistemit të tregut
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NGO	Organizata joqeveritare
OC	Rezultati

OF	Fondi i mundësive
PPSE	Promovimi i punësimit në sektorin privat
SC	Komiteti drejtues
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SEC	Trupat e ekspertëve seniorë
SGDM	Metodologjia e Saint Gallen-it për menaxhimin e destinacioneve
SHTIB	Shoqatë e shitësve të lëndës së parë
SIF	Fondi për përfshirjen sociale
SME	Ndërmarrje e vogël dhe e mesme
SRP	Paneli për shqyrtimin strategjik
ToR	Termet e referencës

## 1. Informatat themelore

Shteti: Kosovë	Emri i projektit: Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)
SDC No SAP:	
Fusha e strategjisë së bashkëpunimit: ENE	

Synimi	NVM-të që veprojnë në sektorët ekonomikë të mirë-organizuar dhe përfshirës, që sigurojnë rritje të punësimit të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë.
Rezultatet (OC)	Rezultati 1: NVM-të e sektorëve të përzgjedhur rrisin produktivitetin e tyre dhe gjenerojnë të ardhura shtesë dhe punësim.  Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, eficiencën dhe konkurrueshmërinë në sisteme të përmirësuara dhe të mirë-organizuar në tregun gjithëpërfshirës.

Kohëzgjatja e fazës së projektit: 16.11.2017-15.11.2021	Periudha e raportimit: 01.01.2019-30.06.2019
--	---

Buxheti në këtë fazë (CHF) 7,276,126,50	Buxheti i planifikuar për vitin 2019 (CHF) 1,938,430
Buxheti i shpenzuar në këtë fazë (CHF) 2,990,472	Buxheti i shpenzuar nga 01.01.2019 -30.06.2019 (CHF) 864,124

Informacion mbi kontributet e partnerëve dhe/ose donatorëve të tjerë (llogaritur në CHF) 100% SDC
--

Organizatrat zbatuese:	Swisscontact dhe Instituti Riinvest
Partnerët kryesorë kombëtarë: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Odat Ekonomike, firmat kryesore	Partnerët kryesorë ndërkombëtarë: n/a

Koordinatorë e projektit Argjentina Grazhdani	Numri i stafit të projektit Kombëtar: 16
Konsulentët ndërkombëtar (ditët e planifikuara): <sup>1</sup> 20	Konsulentët ndërkombëtar (ditët e ekzekutuara) <sup>2</sup> : 20
Konsulentët kombëtar (ditët e planifikuara): 20	Konsulentët kombëtar: (ditët e ekzekutuara): 0
Riinvest (ditët e planifikuara): 48	Riinvest (ditët e ekzekutuara): 12
Swisscontact (ditët e planifikuara): 48	

<sup>1</sup> Konsulencia të tjera ndërkombëtare dhe lokale janë planifikuar përmes buxhetit të pjesës 4 lidhur me vlerësimet dhe intervenimet tek tre rezultatet e PPSE-së (Shih shtojcën III).

<sup>2</sup> Konsulencia të tjera ndërkombëtare dhe lokale janë planifikuar përmes buxhetit të pjesës 4 lidhur me vlerësimet dhe intervenimet tek tre rezultatet e PPSE-së (Shih shtojcën III).

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Në periudhën e raportimit, PPSE-ja ka vazhduar shkallëzimin dhe zgjerimin e intervenimeve të filluar në vitin e I-rë të fazës së II-të. Në mënyrë të veçantë, për sektorin e ushqimeve dhe përbërësve natyral (së këndejmi FNI; ang. Food and Natural Ingredients), është zbatuar intervenimi për fuqizimin e bujqësisë kontraktuese nëpërmjet 4 partneriteteve, duke rezultuar me **106 fermerë të rinj përfitues dhe 117 hektarë shtesë të prodhimit**. Intervenimi për zhvillimin e produkteve ka gjeneruar me **9 produkte dhe 3 kultura të reja**. Përmes shërbimeve me vlerë të shtuar, NVM-të kanë përfituar nga shërbimet mbështetëse, të tilla si: certifikimi i standardeve të cilësisë, sigurimi i njohurive të teknologjisë ushqimore, marketingut dhe lehtësimi i eksporteve. Në sektorin e turizmit, intervenimet ishin të përqendruara në rajonin e Prishtinës dhe Prizrenit, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e produkteve të reja të turizmit dhe aktivitetet e koordinimit të sektorit, ndërsa vijon më tej zhvillim i turizmit në Pejë. Sa i përket periudhës së raportimit, 4 NVM kanë prezantuar **5 produkte të reja të turizmit: parashutizëm (ang. paragliding), lundrim me varkë - kajak (ang. kajaking) dhe çiklizëm në Prizren; dhoma e arratisjes në Prishtinë; dhe kampingu në Pejë**. Përkundër një reagimi të ngadaltë nga aktorët publikë dhe privatë për mundësitë e investimeve në turizëm, në periudhën raportuese PPSE-ja ka vërejtur një angazhim të shtuar të sektorit privat dhe angazhim për të investuar nga sektori publik.

Fondi i Mundësive (ang. Opportunity Fund - OF) është integruar më tej brenda intervenimeve të sektorit, duke mbështetur projektet e bashkë-investimit që synojnë të promovojnë rritjen e qëndrueshme të zinxhirit të vlerës, këtë vit duke u përqendruar më shumë në sektorin e turizmit. Në periudhën raportuese është nënshkruar një marrëveshje bashkë-investimi, me qëllim të prezantimit të një shtegu natyror dhe parku argëtues si mundësi rekreative publike shumë sezonale siç është Pylli Arinjëve në Prishtinë. Ndërsa përmes Fondit të Përfshirjes Sociale, në gjysmën e parë të vitit, janë nënshkruar tre marrëveshje me partnerë minoritarë, dy prej tyre janë biznese dhe një OJQ.

Në kuadër të sektorit të FNI-së janë zbatuar gjithsej 5 intervenime: fuqizimi i sistemit të bujqësisë së kontraktuar, zhvillimi i produkteve, prezantimi i prodhuesve të specializuar të farërave, lehtësimi i programeve të certifikimit dhe promovimi i lidhjeve për eksport. Në sektorin e turizmit, gjithsej 5 intervenime janë duke vazhduar, duke u përqendruar kryesisht në zhvillimin e produkteve të turizmit në Prishtinë dhe Prizren, promovimin e Kosovës në tregjet turke dhe gjermano-folëse, aktivitetet e koordinimit të sektorit dhe organizimin afatshkurtër joformal të trajnimeve për udhërrëfyes/guida turistik.

Të gjitha rezultatet për treguesit e ndikimit janë në përputhje me rezultatet e parashikuara gjashtë-mujore. Si rezultat i të gjitha aktiviteteve të zbatuara në periudhën raportuese, intervenimet e PPSE-së kanë rezultuar me **886 gra dhe burra të punësuar, ekuivalente me 237 punë me orar të plotë**. Intervenimet në sektorin e FNI-së kontribuojnë me rreth 93% të këtij rezultati në krahasim me 7% nga sektori i turizmit. Sa i përket punësimit të grave dhe minoriteteve, PPSE-ja është gjithashtu në përputhje me objektivat e parashikuara për këtë fazë, duke arritur në 49% përkatësisht 53%. Përfitimet e punësimit kanë arritur shifrën rreth 729,893CHF (franga zvicerane), ndërsa NVM-të përfituese kanë regjistruar rreth 412.507CHF të ardhura neto shtesë.

### 3. Raportimi i arritjes së rezultateve

#### 3.1. Ndikimi

NDIKIMI: NVM-të që operojnë në sektorë ekonomikë të mirë-organizuar dhe përfshirës, sigurojnë një rritje të punësimit fitimprurës dhe të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë	Treguesi i ndikimit	Vlerësimi bazë <sup>3</sup> 2017	2018 <sup>4</sup> (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	Ndikimi: FTE të punësimit shtesë neto	850 FTEs	T= 500 FTEs A= 237 FTEs	47%	2,000 FTEs	36%
	Punësimi shtesë neto (gratë) FTEs	270 FTEs	T= 150 FTEs A=104 FTEs	70%	600 FTEs	49%
	Punësimi shtesë neto (minoritetet) FTEs	75 FTEs	T= 50 FTEs A=8 FTEs	16%	150 FTEs	53%

Në tremujorin e parë të vitit 2019, intervenimet e PPSE-së kanë krijuar rreth **237 punë me orar të plotë**. Intervenimet në sektorin e FNI-së kontribuojnë në rreth 93% të këtij rezultati në krahasim me 7% të sektorit të turizmit. Ky trend vazhdon nga faza e I-rë, e cila është e ndikuar kryesisht nga mundësitë më të larta të krijimit të vendeve të punës në bujqësi dhe rritjen në sektorin e turizmit pa përfshirë turizmin. Sidoqoftë, numër më i lartë i të punësuarve në sektorin e turizmit pritet të gjenerohet në dy vitet e fundit të zbatimit të intervenimeve. Të gjitha rezultatet për treguesit e ndikimit janë në përputhje me rezultatet e parashikuara gjashtë mujore.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, sektori FNI ka gjithsej 5 intervenime në proces e sipër<sup>5</sup>, konkretisht intervenime në forcimin e **sistemit të bujqësisë së kontraktuar** (4 partnerë), **zhvillimin e produkteve** (4 partnerë dhe një ofrues të shërbimit/bashkë-lehtësues), **prezantimin e prodhuesve të specializuar të farërave** (2 partnerë), dhe **lehtësimin e programeve të certifikimit** (1 partner të BMO-së) **mbështetje për lidhjet tregtare** (1 ofrues partner të shërbimeve/bashkë-lehtësues). Në kuadër të bujqësisë së kontraktuar, PPSE-ja është përqendruar në mbështetjen e kontraktuesve të rinj në zgjerimin e rritjes të tyre si fermerë si dhe rritjes së prodhimit, ku shumica e rezultateve janë gjeneruar.

Për të mbështetur më tej prodhimin e kontraktuar, ekipi ka vazhduar të mbështesë fidanishte të specializuara për farëra të perimeve. Rezultate pozitive janë regjistruar përmes aktiviteteve në promovimin e lidhjeve të eksportit dhe lidhjeve tregtare. PPSE-ja vlerëson se intervenimet e FNI-së gjithsej kanë krijuar rreth **220 vende të reja pune**. Validimi dhe zberthimi i mëtutjeshëm i të dhënave do të bëhet përmes vlerësimeve të ndikimit (në kohën kur cikli/sezoni ka përfunduar) dhe do të paraqitet në raportin e fund-vitit.

<sup>3</sup> Bazuar në arritjet e Fazës së I-rë

<sup>4</sup> Kolona paraqet rezultatet e matura brenda raportit të raportimit

<sup>5</sup> Shih aneksin X: listën e ndërhyrjeve në sektorin e FNI-së dhe sektorin e turizmit.

Sektori i turizmit ka gjithsej 5 intervenime në proces, të përqendruara kryesisht në intervenimet rreth zhvillimit të **produkteve të turizmit** (1 intervenim), promovimin e Kosovës për **tregun turk dhe promovimin ndërkombëtar** (2 intervenime), aktivitetet për **koordinim të sektorit** dhe organizimin e **trajtime afat-shkurtra joformale** (2 intervenime) për udhëzuesit/guidat turistike. Ekipi ka lehtësuar aktivitetet në lidhje me identifikimin e bizneseve të mundshme të sektorit privat dhe mundësitë për zhvillimin e produkteve të turizmit. Fokusi ka qenë në rajonin e Prizrenit dhe Prishtinës, ku është mbështetur ekspertiza edhe për identifikimin e turizmit të mundshëm publik. Sa i përket promovimit ndërkombëtar për **tregjet gjermano-folëse, tregun turk dhe atë rajonal**, ekipi ka mbështetur përpjekjet e promovimit ndërkombëtar përmes prezantimit të ofertës së Kosovës për agjencitë turke dhe zvicerane, udhëtimeve familjarizuese si dhe organizimin e panairëve.

Trendi i turizmit në Kosovë vazhdon të regjistroj rritje sa i përket numrit të turistëve. Konkretisht, Agjencia e Statistikave të Kosovës<sup>6</sup> paraqet se në vitin 2018 numri i turistëve ndërkombëtarë është dyfishuar, nga 167,234 në vitin 2017 në 192,761 në vitin 2018 (15% rritje). Ndërsa, koha mesatare e qëndrimit në vitin 2018 është rritur pak, por mbetet akoma nën 2 netë për turist. Në përgjithësi, numri i netëve të qëndrimit për turistët ndërkombëtarë **në vitin 2018 ka arritur në 321.308 në total**. Për këtë periudhë raportuese, intervenimet e PPSE-së kanë gjeneruar rezultate të drejtpërdrejta që mund t'i atribuohen rreth **17 vende pune shtesë me orar të plotë**. Vende të tjera të punës dhe të nxitura nga intervenimet në turizëm do të vlerësohen deri në fund të vitit dhe do të paraqiten në raportin vjetor.

Puna e PPSE-së ka çuar në rezultatet e raportuara përkundër kontekstit të pasigurt politik dhe ekonomik. Taksa 100% e doganës për produktet serbe dhe boshnjake ka vazhduar të zbatohet gjatë periudhës së raportimit. PPSE-ja nuk ka qenë në gjendje të vlerësojë efektin e taksës, pasi që partnerët tanë nuk kanë raportuar ndonjë implikim domethënës në biznesin e tyre të përditshëm. Sidoqoftë, në disa raste është vërejtur se taksa ka pasur edhe ndikim pozitiv, por edhe ndikim negativ në performancën e NVM-ve. Pak kompani kanë përfituar nga një konkurrencë e zvogëluar, për shkak të mungesës së konkurrencës nga Serbia, ndërsa të tjerët janë përballur me vështirësi në furnizim me lëndë të parë dhe makineri, gjë që ka sjellë rritje të çmimit të importit. Siç është raportuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2019) inflacioni i çmimeve të konsumit ishte rreth 3.2% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018, sikurse inflacioni i çmimit të importit (3.5% në tremujorin e parë të 2019). Ndërsa, inflacioni i çmimeve të prodhuesve ishte disi më i ulët, ose rreth 1.8% në tremujorin e parë të vitit 2019 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) (2019) projektton një inflacion prej rreth 2.2% në vitin 2019, një normë ekonomike dhe pranueshme e inflacionit.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, treguesit e përgjithshëm të punësimit dhe të papunësisë mbeten pothuajse të njëjtë në tremujorin e parë të vitit 2019, me një tendencë të lehtë në rënie të punësimit dhe rritje të papunësisë. Ndërsa, në tremujorin e dytë, shkalla e punësimit është rritur me 1.8 pikë përqindje dhe shkalla e papunësisë është ulur me 4.1 pikë përqindje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Për sa i përket rritjes ekonomike, ASK (2019) raporton se në tremujorin e parë të vitit 2019, GDP-ja vlerësohet të ketë një rritje reale prej 4%. Hotelet dhe restorantet si dhe industria përpunuese paraqesin një rritje prej rreth 1.4%, ndërsa vlera e shtuar e bujqësisë në GDP është si në të njëjtën periudhë në vitin 2018. Vlerësimet e GDP-së janë pozitive edhe për pjesën tjetër të vitit. FMN (2019) projektton një normë reale të rritjes ekonomike prej rreth 4.2% në vitin 2019.

<sup>6</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës [http://askdata.rks.gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata\\_Tourism%20and%20hotels/?rxid=c8d59138-4e73-429d-86fd-6675b3c8a96f](http://askdata.rks.gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata_Tourism%20and%20hotels/?rxid=c8d59138-4e73-429d-86fd-6675b3c8a96f)



Një shqetësim në rritje i ngritur nga sektori privat ka të bëjë me migracionin dhe disponueshmërinë e fuqisë punëtore. Disa raporte pohojnë se vetëm në vitin 2018, numri i kosovarëve që janë larguar nga Kosova ishte 34.500<sup>7</sup>. Ky trend ka vazhduar, mbase edhe është rritur, në vitet e fundit. Trendi i migrimit për punë ka ndikim të drejtpërdrejtë në disponueshmërinë e fuqisë punëtore në sektorin privat. Kjo konfirmohet nga bashkëpunëtorët e PPSE-së, veçanërisht ata të lidhur me bujqësinë, ku numri i punëtorëve në dispozicion po pakësohet nga dita në ditë.

Për më tepër, partnerët e PPSE-së raportojnë se një numër në rritje i fermerëve po e lënë vendin për mundësi të reja për në vendet e BE-së. Si implikim kryesor, pritet që zhvillimi i ardhshëm i bujqësisë në Kosovë të jetë i prirur të zhvendoset nga një sektor ku faktori punë është intensiv në atë ku faktori kapital është më intensiv, me një tendencë që të ketë më pak ferma të vogla dhe më shumë ferma të mëdha dhe industriale.

### 3.2. Rezultati 1: Konkurrueshmëria e sektorëve të përzgjedhur

Rezultati 1: Të rinjtë, gratë dhe minoritetet përfitojnë nga punësimi fitimprurës dhe gjithëpërfshirës, i krijuar në NVM dinamike në sektorët në rritje	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	2019 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OC 1.1 Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga	0	T= 1,250 A= 886	71%	5,000	52%
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga (gratë)	0	T= 375 A=385	103%	1,500	71%
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga (minoritetet)	0	T= 125 A=20	16%	500	30%
	OC 1.2 Rritja e të ardhurave për 5,000 burra dhe gra përmes pagës / të hyrave	0	T= CHF 2,400,000 A=CHF 729,893	30%	CHF 9,600,000	25%

Ndërhyrjet e sektorit të FNI-së, kryesisht në nivelin e bujqësisë, vlerësohet të kenë gjeneruar **mundësi punësimi për 859 persona**, me një strukturë gjinore të vlerësuar rreth **44% femra dhe 56% meshkuj**, dhe me një fitim të vlerësuar prej **617,000 € rritje të të hyrave** përmes pagës/të hyrave . Për shkak të mbështetjes më të lartë në nivel të përpunimit, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e produktit dhe promovimin e eksportit, të paktën 10% e punëve me orar të plotë janë gjeneruar në këtë nivel.

Kompanitë më të vogla të përpunimit janë duke rritur investimet në zhvillimin dhe azhurnimin e produkteve përfundimtare, duke iu shtuar vlerë produkteve të tyre, si dhe duke u përqendruar në

<sup>7</sup> <https://www.koha.net/arberi/179463/100-mije-qytetare-lane-kosoven-e-shqiperine-vitin-e-kaluar/>

segmentet ku ata kanë më shumë forcë dhe mund të jenë më konkurrues në tregun e brendshëm. Kompanitë janë gjithnjë e më të interesuara për të trajnuar stafin e tyre, veçanërisht teknologët e ushqimit të cilët janë kryesorë për zhvillimin e produktit, cilësinë dhe konsistencën e prodhimit.

Disa përpunues të vegjël dhe qendra të grumbullimit, në sektorin e bimëve medicinale aromatike (ang. medical aromatic plants – MAP) të cilët deri më sot kanë eksportuar përmes distributorëve më të mëdhenj, tani gradualisht po maturohen për t'u bërë eksportues individualë, madje edhe për produkte më të sofistikuara përfundimtare, p.sh. vajrat esenciale. Kompanitë më të mëdha të përpunimit të ushqimit janë duke kërkuar mundësi të reja eksporti dhe kanë reaguuar mjaft pozitivisht ndaj PPSE-së për lehtësimin e krijimit të lidhjeve me blerësit zviceranë. Ata po përdorin gjithashtu inteligjencën e eksportit të marrë përmes procesit të lehtësimit për të rivendosur strategjitë e tyre të eksportit bazuar në kërkesën e blerësve të eksportit. PPSE-ja është duke i ndjekur këto ndryshime dhe duke e përshtatur strategjinë bazuar në ndryshimet dhe nevojat e tregut.

Ndikimi i vlerësuar i intervenimeve në sektorin e turizmit për gjashtëmuorin e parë ka krijuar **punësim shtesë** për të paktën **27 persona (19 meshkuj dhe 8 femra)**. Të ardhurat e përgjithshme që i atribuohen personave të punësuar arrin shifrën e **52,000 €**. Në rajonet ku ka punuar PPSE-ja, përgjigjja e sektorit privat të turizmit për zhvillimin e produktit ka qenë mjaft e ngadaltë, veçanërisht në krahasim me interesimin e Komunës së Prizrenit dhe të Prishtinës si dhe sektorit privat në rajonin e Pejës. Për më tepër, ekipi ka vërejtur një interesim nga komunat e tjera (Gjilan, Deçan, Podujevë, Gjakovë) për të replikuar dhe shtuar aktivitetet e iniciuara nga PPSE-ja në komunat Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Detajet e intervenimeve dhe aktivitetet që do të çojnë në rezultate janë paraqitur në detaje nën rezultatet përkatëse.

Në periudhën raportuese, PPSE-ja ka vërejtur një angazhim të shtuar të zyrtarëve komunalë të sektorit publik në zhvillimin e zonave të turizmit. Në komunën e Prizrenit dhe të Pejës, disa atraksione më të mëdha turistike janë në proces të planifikimit/zhvillimit. Në Prishtinë, përkundër përparimit të ngadaltë nga sektori publik dhe privat, ka indikacione për investime të ardhshme publike në atraksionet e reja rreth parkut të Gërmisë. Gjithashtu, është vërejtur që kompanitë e transportit janë më pro-aktive si përgjigje ndaj numrit në rritje të turistëve dhe nevojave të operatorëve turistikë. Rritja e numrit të hoteleve, shikueshmërisë dhe regjistrimit në platformat ndërkombëtare të rezervimit në internet është gjithashtu një tregues tjetër, për një rritje të turistëve ndërkombëtarë të cilët vijnë në Kosovë.

**Të arriturat 1.1 NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve.**

Të arriturat 1.1. NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2019 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë	
	OP 1.1. Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe të përmirësuara të promovuara përmes NVM-ve	0		T= 38 A=17	44%	150	35%
	OP 1.1.2 Vlera shtesë e investimeve për produktet dhe shërbimet e reja	0		T= CHF 1,250,000 A=CHF 412,507	33%	CHF 5,000,000	28%

	OP 1.1.3 Numri i NVM-ve që ofrojnë produkte dhe shërbime të reja dhe të përmirësuara	0	T= 25 A=12	48%	100	28%
--	--	---	---------------	-----	-----	-----

PPSE-ja ka vazhduar të mbështesë NVM-të në **sektorin FNI**, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë dhe të diversifikojë produktet përfundimtare të përpunuara përmes ndërhyrjes së saj dhe Fondit të mundësive (ang. Opportunity Fund – OF). Kjo mbështetje është lehtësuar përmes llojeve të ndryshme të mekanizmave dhe instrumenteve të përdorura në kuadër të intervenimit **“Zhvillimi i Produkteve”**. Llojet e ndryshme të mekanizmave të përdorura janë si në vijim: Trajnimi për rritje dhe ekspertizë në teknologjinë ushqimore - lehtësuar nga CEED Kosova; Përmirësimi i linjave të përpunimit, mbështetje individuale këshilluese për NVM-të përmes misioneve të Trupave të ekspertëve seniorë (ang. Senior expert corps –SEC). Në përgjithësi, 14 NVM kanë përfituar nga aktivitetet e lartpërmendura.

Dhjetë NVM të mbështetura nga PPSE-ja kanë prezantuar rreth 9 produkte të përpunuara përfundimtare<sup>8</sup> dhe 3 kultura të reja<sup>9</sup> gjatë këtij gjashtëmujori (2 janë të njëjta me vitin 2018). Këto janë mundësuar përmes shërbimeve të ndryshme mbështetëse të përmendura më lart si dhe investimeve të ndërmarra nga NVM-ve me rreth 322,000 €.

- Përmes intervenimit **“Zhvillimi i Produkteve”**, PPSE-ja ka bërë partneritet me CEED Kosova si ofrues të shërbimit dhe bashkë-lehtësues për të përmirësuar strategjinë e biznesit dhe zhvillimin e produkteve si dhe shërbimeve të reja. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të këtij partneriteti përfshihen: mbështetja e NVM-ve me trajnime për teknologjinë ushqimore, trajnimin e brendshëm për zhvillimin e produkteve/shërbimeve të reja dhe vizita studimore në ndërmarrjet që shërbejnë si njësi matëse në vendet e rajonit. Një aktivitet të rëndësishëm, të cilin e kemi mbështetur ka qenë një trajnim për teknologjinë ushqimore, ku 7 kompani të sektorit të bylmetit përmes 8 teknologëve ushqimorë kanë marrë pjesë në një program intensiv të avancuar dhe të specializuar në Plovdiv. Si një përsëritje e këtij modeli, PPSE-ja planifikon të përkrahë grupin e dytë të teknologëve të ushqimit (nën-sektori i frutave dhe perimeve) për programin e specializuar në nëntor të vitit 2019 në Universitetin Plovdiv për teknologjinë ushqimore. Ekipi ka intervistuar partnerë dhe përfitues nga viti 2019 dhe 2018 (nga platforma “trajnim për rritje” dhe intervenime të tjera). Gjashtë NVM kanë prezantuar 9 produkte të reja përfundimtare dhe kanë gjeneruar rreth 250,000 € shitje shtesë nga këto produkte. Kjo tregon që mbështetja ndaj inovacionit dhe produkteve të reja përmirëson performancën e NVM-ve.

PPSE ka mbështetur gjithashtu 4 NVM në shkallë të vogël (Natyra, Albini, Kastrioti - në pronësi të grave, TP N&N Komerc - në pronësi serbe) për të avancuar makinat e tyre të përpunimit dhe/ose paketimit, me qëllim përfundimtar për të përmirësuar produktet aktuale dhe prezantimin e produkteve të reja. Dy prej këtyre kompanive janë mbështetur gjithashtu me shërbime të mbështetjes së biznesit (d.m.th. brendimi dhe shërbimet e dizajnit të produkteve), kështu që procesi i zhvillimit të produktit është më mirë i strukturuar dhe i planifikuar. PPSE-ja është e angazhuar që të vazhdojë të mbështesë NVM-të e sektorit që janë të gatshëm të prezantojnë produkte të reja me shërbime të përshtatura të marketingut, të jenë konkurrues me brendim profesional dhe dizajnimin e produkteve të reja. Është e rëndësishme të përmendet që shumica e rezultateve pritet të jenë në pjesën e dytë të vitit.

<sup>8</sup> Produktet përfundimtare përfshijnë: qershi të ngrira dhe të paketuara, çokollata pralina, krem nga kamomila dhe calendula, salca të domateve, produkte ushqimore të gatshme.

<sup>9</sup> Kultura të reja të kontraktuara përfshijnë: trumzë, domate qershi dhe presh organik.

Së fundi, sektori i FN-së ka mbështetur 3 NVM me trajnim të specializuar afatshkurtër brenda kompanisë nga konsulentët e SEC, zhvillim të produkteve, të recetave dhe marketing për produktet e reja.

Deri në periudhën raportuese, intervenimi për **“Zhvillimin e produkteve të turizmit”** ishte përqendruar në komunën e Prishtinës dhe të Prizrenit duke **shënjestruar segmentin për aventura dhe segmentin kulturor të turistëve**. Kjo është bërë në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat, duke çuar deri më tani në prezantimin e pesë produkteve të reja të turizmit: **parashutizëm (ang. paragliding), lundrim me varkë - kajak (ang. kayaking) dhe çiklizëm në Prizren; dhoma e arratisjes në Prishtinë; dhe kampingu në Pejë**.

Duke marrë parasysh reagimin e ngadaltë të sektorit privat, ekipi ka vendosur të aplikojë një qasje të dyanshme, duke u bërë partner me bizneset private për bashkë-investim në produkte dhe partneritet me komunitat dhe aktorët privatë rreth produkteve dhe atraksioneve kulturore me vlerën e investimit - të cilat kërkojnë leje për shfrytëzim të tokës dhe sasi të mëdha investimesh. PPSE-ja vazhdon të punojë për zhvillimin e tetë produkteve të reja shtesë në natyrë me partnerë të sektorit privat dhe tre muze me Komunitat e Prishtinës dhe komunën e Prizrenit.

**Pesë** produktet e reja të turizmit janë lansuar nga **katër NVM**, me qëllimin kryesor për të tërhequr numër në rritje të turistëve. Këta pronarë të produkteve kanë regjistruar investime totale prej mbi **56,000€**. Këto produkte tashmë kanë regjistruar si qarkullim të drejtpërdrejtë me mbi 16,500€ për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, ndërsa numri i përgjithshëm i NVM-ve përfuturore (në mënyrë direkte dhe indirekte) vlerësohet të jetë rreth 15.

- Në kuadër të intervenimit **“Zhvillimi i produkteve të turizmit”** me aktorë privatë dhe publik, PPSE-ja ka bërë partneritet me Aerklubi ‘Shkaba’, Supercampers, Wander, dhe RAZ për zhvillimin e pesë produkteve të reja të lansuara (përmendur më lart). Në këtë gjashtëmujor, PPSE-ja gjithashtu ka bashkëpunuar me Alpine Club Sharri dhe Marimangat për të zhvilluar dy shtigje via-ferratas të reja (në Prizren dhe Pejë). Partneritetet e mëtutjeshme janë duke u negociuar me Pyllin e arinjëve (Shtegu i natyrës dhe parku i argëtimit në Badovc), Proton (Zip-line në Prizren), Eco Alpina (Rekreacion dhe argëtim pranë lumit në Pejë) dhe BNA (Bungy Rocket në Pejë) për zhvillimin e produkteve dhe aktiviteteve të turizmit në natyrë. Për të nxitur investime të mëtejshme të sektorit privat në produktet e turizmit, ekipi ka bërë një vlerësim të shpejtë me 33 biznese në rajonin e Prizrenit, kryesisht në zonën Zhupa dhe Prevallë. Bazuar në potencialin dhe interesimin, ekipi ka mbështetur më tej pesë biznese me vlerësim teknik individual nga kompania GEODE, e cila i ka propozuar secilit biznes produkte specifike të turizmit që i përshtaten nevojave të biznesit, segmenteve të tregut dhe kapaciteteve investuese. Në bashkëpunim me komunitat përkatëse, e njëjta kompani (GEODE) ishte e angazhuar edhe për identifikimin e produkteve të turizmit në parkun kombëtar të Gërmisë dhe liqenin Livoq (Gjilan) si dhe përmirësimin e hyrjes në kalanë e Prizrenit përmes ndërtimit të teleferikut. Ndërtimi i teleferikut pritet të fillojë në vitin e ardhshëm, për të cilin komuna do të ndajë buxhet bazuar në studimin e fizibilitetit. Ekipi gjithashtu, ka lansuar një thirrje të hapur në përpjekje për të tërhequr bizneset për të investuar në produktet e turizmit për rajonin e Prishtinës.

PPSE gjithashtu është duke lehtësuar aktivitetet me Komunitat e Prishtinës dhe të Prizrenit, për krijimin e dy muzeve të rinj në Prizren, përkatësisht muzeun “Filigran” dhe muzeun “Nëna Terezë”, dhe zbatimin e projekteve të iniciuara në vitin 2018: “Muzeun e shtëpisë shkollë të familjes Hertica” dhe muzeun “Streha e artit” në Prishtinë. Për më tepër, dy nisma të reja nga sektori privat në Prishtinë janë paraqitur për krijimin e “Muzeut Simon Shiroka” dhe “Muzeut të Historisë

gojore”. Komuna është në proces të gjetjes dhe sigurimit të lokacioneve për të dy muzetë, si dhe për mbështetje financiare.

### Të arriturat 1.2: NVM-të kanë rritur prodhimin.

Të arriturat 1.2 NVM-të kanë rritur prodhimin	Treguesi i të arriturve	Vlerësimi bazë 2017	2019 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
OP 1.2.1 Numri i fermave dhe NVM-ve të përfshira në bujqësi kontraktuese		350 SME	T= 250 SME A= 106 SME	42%	1,000 SME	44%
OP 1.2.2 rritja e prodhimit të kontraktuar		200 ha	T= 125 ha A= 117 ha	94%	500 ha	104%

PPSE ka lehtësuar dy intervenime kryesore që synojnë të rrisin cilësinë dhe vëllimin në prodhimin primar për nën-sektorët e zgjedhur. **‘Fuqizimi i sistemit të bujqësisë së kontraktuar’** vazhdon të jetë një nga intervenimet kryesore të PPSE-së. Ka filluar si intervenim në fillim të fazës së I-rë, me pak fermerë (rreth 20) dhe (2) partnerë, që prezantojnë sistemin e bujqësisë së kontraktuar në sektorin perimeve, duke prezantuar fara cilësore të domateve industriale.

Kjo është adaptuar dhe zgjeruar vazhdimisht nga partnerët dhe fermerët, duke integruar inputet cilësore dhe shërbimet e vlerës shtuar në sistemin e bujqësisë së kontraktuar. Motivi kryesor i fermerëve për angazhimin e tyre në një model të tillë është siguri i hyrjes në një treg të sigurt për produktet e tyre. Kontraktimi u mundëson fermerëve që të planifikojnë prodhimin e tyre vjetor më mirë dhe të sigurojnë të ardhurat e tyre, përpunuesit mund të sigurojnë furnizim të vazhdueshëm dhe cilësi për lëndën së parë, ndërsa për qendrat e grumbullimit, të cilat shërbejnë si ndërmjetësues për të bashkuar hendekun e koordinimit midis dy palëve, duke iu siguruar kështu mundësi më të mëdha për fitime.

Këta faktorë kanë kontribuar në rezultate të kënaqshme dhe deri në fund të fazës së I-rë, numri i fermerëve përfitues nga PPS-ja, të cilët janë të integruar në bujqësinë e kontraktuar ka shkallëzuar deri në rreth 410, duke kultivuar rreth 325 hektarë, duke u zgjeruar në të gjitha rajonet e Kosovës dhe duke përfshirë edhe nën-sektorët e tjerë, siç është ai i bimëve aromatike medicinale.

Në fazën e II-të, bujqësia e kontraktuar po zgjerohet më tej, ku kontraktorët ekzistues (qendrat e grumbullimit dhe përpunuesit) po rrisin kapacitetet e tyre dhe po shfaqen kapacitete të reja, duke rritur numrin e fermerëve të kontraktuar dhe duke ofruar më shumë shërbime për ta, të tilla shërbime si farëra të specializuara, shërbime këshilluese, qasje në makineri (makina për korrje, makina për mbjellje etj.) duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe rendimentit të produktit.

Integrimi i farërave të specializuara në bujqësinë e kontraktuar ka të bëjë me një intervenim tjetër të PPSE-së **“Prezantimi i prodhuesve të specializuar të farërave”**, ku PPSE-ja aktualisht është duke mbështetur dy fidanishte me investime teknologjike në objekte dhe njohuri teknike që synojnë të përmirësojnë cilësinë e farërave të perimeve në treg. Për më tepër, kontraktorët (përpunuesit dhe qendrat e grumbullimit) mbështeten kryesisht me pajisje dhe makineri në mënyrë që ata të mund të zgjerojnë numrin e fermerëve dhe zonave të kontraktuara.

Si rezultat, në dy vitet e fundit, përmes intervenimeve të PPSE-së, 235 fermerë të rinj kanë hyrë në sistemin e bujqësisë së kontraktuar, me rreth 544 hektarë shtesë të kultivuar në kuadër të prodhimit të kontraktuar. Në përgjithësi, numri i fermerëve përfitues të PPSE-së në bujqësi të kontraktuar, që nga Faza e I-rë, vlerësohet të jetë rreth 645 përfitues, me një sipërfaqe të përgjithshme rreth 869 hektarë. Rezultatet e intervenimit në bujqësi të kontraktuar janë dhënë në tabelën më poshtë.

Rezultatet e PPSE-së për bujqësinë e kontraktuar	Faza e I-rë, Total	2018 (Shtesë)	2019 (Shtesë)	PPSE Total
Partnerë	10	7	3	20
Fermerë	410	137	98	645
Hektarë	325	401	143	869

- Në kuadër të intervenimit **“Fuqizimi i sistemit të bujqësisë së kontraktuar”**, ekipi i PPSE-së ka bashkëpunuar me 4 kontraktorë (grupi ADE, Agrocelina, Nektar dhe Agropeti). Në tre raste, mbështetja ka qenë në bashkë-investime për makineri (tharëse, kalibrues, etj.) dhe pajisje (për vjelje) me qëllim kryesor, rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të përpunimit dhe grumbullimit, rritjen e efikasitetit dhe sigurimin e cilësisë së produkteve të kërkuara. Këto kompani janë përzgjedhur kryesisht bazuar në potencialin e tyre për të zgjeruar aktivitetin e tyre dhe bazën e fermerëve. Në një rast, PPSE-ja është duke e mbështetur integrimin e farërave të perimeve të prodhuara në një fidanishte me sistem të bujqësisë së kontraktuar. Përveç katër partnerëve të këtij intervenimi, ekipi është duke monitoruar nga afër, fermerët e kontraktuar dhe zonën e prodhimit, partnerët nga intervenimet e tjera që kanë të bëjnë me bujqësinë e kontraktuar (p.sh. rastet e zhvillimit të produktit) si dhe partnerët ekzistues nga viti 2018. Është e rëndësishme të përmendet, se ekipi ka bërë përpjekje për të shmangur mbivendosje të investimeve me agjencitë e tjera të donatorëve kur ka partneritet me NVM-të. Mbështetja rreth bujqësisë së kontraktuar, veçanërisht në sektorin e MAP-së, vazhdon të jetë shumë produktive dhe me një potencial të lartë rritjeje. Kjo ka çuar në një interes më të lartë dhe përfshirje të donatorëve në këtë sektor, për të cilin ekipi është përgjigjur duke intensifikuar koordinimin dhe shkëmbimin e informatave me agjencitë e tjera të donatorëve.
- Përmes intervenimit **“Prezantimi i prodhuesve të specializuar të farërave”**, qëllimi është që të përmirësohet qasja dhe cilësia e farërave për fermerët e perimeve dhe MAP-së. Ky intervenim është i lidhur ngushtë me intervenimin për bujqësi të kontraktuar dhe pritet të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë dhe rendimentin e prodhimit parësor. Gjatë vitit 2018, PPSE-ja, përmes Fondit e mundësive ka mbështetur krijimin e **një fidanishte të re moderne (Agrobora)** dhe përmirësimin e një fidanishte ekzistuese (**Fidanishtja e Godancit**) për prodhimin e farërave të perimeve.

Fidanishtja e sapokrijuar ‘Agrobora’ është finalizuar dhe është lansuar në qershor të vitit 2019 dhe funksionimi i saj ka filluar menjëherë. Pjesa e dytë e investimeve në “Fidanishtja e Godancit” për përmirësimin e fidanishtes ekzistuese pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2019. Vetëm me investimet e bëra vitin e kaluar (linja mbjellëse dhe teknologji të reja të prodhimit), “Fidanishtja e Godancit” ka rritur efikasitetin e brendshëm dhe produktivitetin (duke prodhuar pesë deri në dhjetë herë më shumë farëra dhe duke zvogëluar shkallën e dështimit mesatarisht me 15%), si dhe duke përmirësuar cilësinë e farërave

(me potencial më të lartë të rendimentit dhe më rezistente ndaj sëmundjeve). Ndryshimet dhe përfitimet nga një fidanishte moderne dhe farërat e saj në nivelin e fermerëve, pritet të shihen në një fazë të mëvonshme, duke filluar nga sezoni i dytë i vitit 2019. Përveç kësaj, PPSE-ja gjithashtu, është e përkushtuar t'i mbështesë këto fidanishte partnere me njohuri dhe përvojë përmes ekspertëve të fushës, si gjatë procesit të investimeve ashtu edhe gjatë procesit të prodhimit. Ekipi planifikon të intensifikojë dhe zgjerojë integrimin e fidanishteve partnere në kuadër të intervenimeve për bujqësi të kontraktuar, deri sa këto fidanishte të kenë përfunduar dhe të jenë plotësisht funksionale. Ne presim që prodhimi i specializuar i farërave do të kopjohet nga prodhuesit e tjerë si dhe kjo do të çojë në ndryshimin e dëshiruar sistematik në treg, i cili synon të ndryshojë mënyrën se si fermerët prodhojnë farëra në Kosovë.

### 3.3. Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, eficiencën dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara

Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, eficiencën dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	2019 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OC 2.1 Numri i NVM-ve përfitojnë nga përdorimi i shërbimeve të reja ose të përmirësuara mbështetëse	0	T= 38 SMEs A= 25 SMEs	66%	150 SMEs	27%
	OC 2.2 Rritja shtesë neto e të ardhurave e 150 NVM-ve	0	T= CHF 950,000 A=CHF 156,651	16%	CHF 3,800,000	19%
	OC 2.3 Institucionet janë më të përgjegjshme për rritjen e sektorit privat	0	<i>Vlerësimi cilësor bazuar në diskutimet e fokus grupeve të personelit kryesor të institucionit <sup>10</sup></i>			

NVM-të e sektorit privat në sektorin e FNI-së, kohët e fundit kanë rritur interesimin dhe investimet e tyre për zhvendosjen e operacioneve të tyre në drejtim të mekanizimit. Kjo është rrjedhojë e dy faktorëve: njëri faktor lidhet me nivelin e tyre të rritjes dhe përpjekjet për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe efikasitetin, dhe tjetri - më urgjent, lidhet me numrin në rënie të shpejtë të disponueshmërinë së fuqisë punëtore. NVM-të e vogla po rrisin gradualisht kërkesën e tyre për shërbime mbështetëse, për ato shërbime që i shtojnë vlerë produkteve të tyre përfundimtare dhe përmirësojnë qasjen e tyre në tregjet vendore dhe ndërkombëtare, siç janë certifikimi i standardeve të cilësisë, brendimi dhe dizajni i produkteve të tyre. Ndërmarrjet më të mëdha kërkojnë kryesisht lehtësira tregtare për eksport.

Në vitin 2019, **25 NVM** shtesë partnere dhe/ose përfituese **tashmë janë duke përfituar nga shërbimet e reja mbështetëse** që janë lehtësuar nga PPSE-ja që nga viti 2018. NVM-të përfituese kanë përdorur kryesisht shërbime të mbështetura nga PPSE-ja rreth programeve të certifikimit, shërbimeve të zhvillimit të produkteve dhe lehtësimit tregtar. Në të gjitha ndërhyrjet e FNI-së, NVM-të përfituese të PPSE-së kanë

<sup>10</sup> Një përmbledhje e shkurtër e diskutimit në fokus grup është paraqitur në pjesën vijuese, ndërsa një raport është bashkangjitur në Shtojcën IX.



raportuar të ardhura neto shtesë prej rreth **108,000CHF** si rezultat i drejtpërdrejtë i intervenimit të PPSE-së.

Në sektorin e turizmit, në gjysmën e parë të vitit 2019, PPSE-ja ka përkrahur tre shërbime të reja mbështetëse në treg. Këto shërbime kanë të bëjnë me trajnime joformale, të kërkuara nga sektori privat - posaçërisht për udhëzuesit/guidat e qytetit dhe udhëzuesit/guidat e malit. Për më tepër, një trajnim për turne me biçikletë malor është mbështetur për sektorin e NVM-ve. Rritja e kërkesës për udhëzues për segmente të ndryshme të tregut është një shenjë shumë e mirë e rritjes së të hyrave së turizmit, dhe gjithashtu paraqet një reagim pro-aktiv të aktorëve të tregut në këtë sektor.

Mbështetje e vazhdueshme intensive është duke iu kushtuar promovimit të Kosovës në tregje specifike, siç është tregu turk, ku gjithsej 57 NVM kanë përfituar nga të gjitha intervenimet e PPSE-së në vitin 2019, me një rritje të raportuar të të ardhurave shtesë neto prej rreth **48,651CH**.

PPSE-ja vazhdon të mbështesë komunat në Kosovë për zhvillimin e produkteve dhe atraksione turistike me një qasje të përfshirjes së sektorit privat. Si rezultat i mbështetjes për Komunën e Prizrenit dhe të Prishtinës, të dy komunat kanë rritur angazhimin për sa i përket ndarjes së buxhetit dhe planifikimin për zhvillimi të turizmit (promovim, produkte, informacion etj.) ndërsa është vërejtur interesim nga komunat e tjera si Gjilani, Deçani, Gjakova, Podujeva, për të përsëritur nisma siç është komuna e Pejës, e Prizrenit dhe e Prishtinës, drejt zhvillimit të produkteve të turizmit, aktiviteteve dhe hartimit të strategjive të turizmit.

Sipas një diskutimi të një fokus grupi, të kohëve të fundit me aktorët e turizmit në Prizren, perceptimi i aktorëve mbetet kryesisht i pakënaqshëm ndaj punës së komunës dhe qeverisë qendrore, pavarësisht se vërehen disa përmirësime kohëve të fundit. Aktorët e turizmit kanë vërejtur përmirësime në lidhje me infrastrukturën, zhvillimin e strategjisë së turizmit dhe përfshirje gjatë procesit, veprimet e komunës rreth infrastrukturës në qendër, procesin administrativ, lëshimin e licencave dhe lejeve si dhe transparencën.

Ndër çështjet kryesore negative të identifikuar nga aktorët e turizmit janë: taksa komunale, mungesa e hapësirave të parkimit për turistët, zhurma me zë të lartë, mungesa e organizimeve, aktiviteteve dhe informacionit, mungesa e investimeve në infrastrukturën turistike, menaxhimi i vendeve kulturore, licencat e udhëzuesve/guidave turistik. Mund të konkludohet se ka pasur shumë nisma pozitive nga Komuna e Prizrenit, ku shenjat e para tashmë mund të shihen, megjithatë kërkohet më shumë kohë në mënyrë që sektori privat të shohë përfitimet.

#### **Të arriturat 2.1: Ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara.**

Të arriturat 2.1: Ofruesit e Shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2019 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% kumulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.1.1 Numri i NVM-ve që përdorin shërbime të reja dhe të përmirësuara të ofruara nga ofruesit e shërbimeve	0	T= 75 SMEs A= 22 SMEs	29%	300	30%

Në kuadër të kësaj të arriture, ekipi i FNI-së ka vazhduar për vitin e tretë të mbështesë një intervenim për "**Lehtësimin e programeve të certifikimit**". Në kuadër të këtij intervenimi, NVM-të kanë qasje në **programin e certifikimit organik dhe BioSuisse**, përmes shoqatës sektoriale Organika. Për më tepër, PPSE-



ja është duke monitoruar nga afër përfituesit që janë duke përdorur shërbime të reja mbështetëse të lehtësuara përmes intervenimeve të PPSE-së që janë në kuadër të arritjeve të tjera, siç janë lehtësimi i tregtisë (misionet e shitjeve/blerësve - OP 2.2), shërbimet e zhvillimit të produkteve (OP 1.1) dhe fidanishtet e specializuara (OP 1.2). Intervenime të reja janë krijuar për të mbështetur NVM-të me shërbime me vlerë të shtuar, siç është prezantimi i shërbimeve të marketingut dhe projektimit të përballueshëm. Deri në fund të vitit, ne presim një numër më të madh të NVM-ve që përdorin shërbime me vlerë të shtuar.

Në vitin 2019, **16 NVM të reja dhe 22 ferma** janë duke përdorur shërbime mbështetëse që janë lehtësuar nga PPSE-ja. Vlen të përmendet se shoqata e sektorit Organika është duke pranuar gjithnjë e më shumë aplikime të NVM-ve për certifikim organik si dhe anëtarësim. Ky mund të jetë një tregues i qëndrueshmërisë për intervenimin.

- Në kuadër të intervenimit **“Lehtësimi i programeve të certifikimit”**, **31 NVM nga të cilat 6 për herë të parë (2 femra, 2 NVM në pronësi të minoriteteve, 1 ndërmarrje shoqërore)** janë në proces të certifikimit organik dhe BioSuisse. Sipërfaqja e pritshme e kultivimit me bimë medicinale aromatike organike për t’u certifikuar në vitin 2019 është më shumë se 600 hektarë. Shërbimet për certifikim organik dhe BioSuisse ofrohen përmes Organika (Shoqata e NWFP dhe NVM-ve nga sektori i MAP-së) nga organi i inspektimit dhe certifikimit Albinspekt nga Shqipëria. Si rezultat i lehtësimit të PPSE-së për lidhjet tregtare, dy NVM-ve të sektorit iu është kërkuar që të marrin certifikimin BioSuisse për hyrjen në tregun zviceran.

Të përkrahura nga PPSE-ja, këto NVM kanë marrë me sukses këtë certifikim dhe kanë arritur të depërtojnë dhe të lidhin kontrata për të hyrë në tregun zviceran. Për më tepër, PPSE-ja ka mbështetur shoqatën Organika në konsolidimin e kapaciteteve të saj, për të ofruar shërbime të zbatimit të certifikimit, që është përgatitja e aplikantëve në përputhje me kërkesat e standardit të certifikimit organik, ku **13 NVM** janë duke e marrë këtë shërbim. Programet e certifikimit kontribuojnë në rritjen e shitjeve dhe të ardhurave, si dhe qasje në tregjet e reja për eksport. Sidoqoftë, PPSE-ja i atribuon vetëm numrin e NVM-ve që përdorin dhe përfitojnë nga shërbimet e certifikimit, ndërsa do të zhvillohet një strategji atribuimi dhe monitorimi i ndikimit për të ardhurat neto shtesë do të raportohet në raportin e fund vitit.

Aktivitetet vijuese, të iniciuara në vitin 2018, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të informacionit (shërbime të këshillimit) me SHTIB (Shoqatë e shitësve të lëndës së parë) kanë përfunduar në vitin 2019. SHTIB ka organizuar një trajnim për 25 agronomë nga dy rajone (Prizreni dhe Peja) të cilët kanë marrë pjesë në një trajnim tre-ditor për praktikën e mira të bujqësisë në sektorin e perimeve, kultivimin, mbrojtjen dhe përdorimin e sigurt të pesticideve. Në fund të trajnimit, 18 agronomë të trajnuar kanë pranuar pajisjet<sup>11</sup> e nevojshme për aktivitetet e tyre në terren dhe mbështetje për fermerët në baza ditore. PPSE-ja do të monitorojë dhe raportojë më shumë detaje për këtë aktivitet në raportin vjetor.

Ekipi ka shqyrtuar mundësinë për të vazhduar më tej mbështetjen e certifikimit Global G.A.P. Kjo është bërë në diskutim me shoqatat ‘Mjedra e Kosovës’, IADK dhe KFC. Sa i përket certifikimit të frutave pyjore të Global G.A.P., ‘Mjedra e Kosovës’ nuk ka shprehur interesim për të ofruar këtë shërbim, prandaj fermat e interesuara duhej të blinin shërbimin individualisht. Megjithatë, është marrë në konsideratë një intervenim për certifikimin e fermerëve/prodhuesve të perimeve që mund të furnizojnë KFC-në me perime të certifikuara, ku IADK është identifikuar si bashkëpunëtor i mundshëm. Ky aktivitet do të pasojë si përfshirje e mundshme gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019.

Për të adresuar kërkesën në rritje të sektorit privat për profesione të specializuara, **dy programe trajnimi joformale** (udhëzues/guida për qytete dhe male) janë mbështetur nga PPSE-ja. PPSE ka bërë partneritet

<sup>11</sup> Sonda për marrjen e mostrave të tokës, njehsorin e pH-së, njehsorin e EC-së, higrometër, lente - xham zmadhues, termometër

me dy operatorë turistik për të përmbushur kërkesën e tyre për rritje të udhëzuesve/guidave. Një marrëveshje ishte arritur me Breath in Travel për të trajnuar **udhëzuesit/guidat frëngjisht-folës** dhe një tjetër marrëveshje me Ballkanin Natyror Adventure për të trajnuar **udhëzuesit/guidat malorë** në Kosovën Perëndimore. Kjo e fundit është duke vazhduar. Një trajnim tjetër i mbështetur është zbatuar me Ride Albania për NVM-të e turizmit për zhvillimin e turneve me biçikleta malore. Gjithsej, 6 NVM shtesë kanë përdorur shërbimet e reja.

Si rezultat i trajnimeve tona, është krijuar një shoqatë e udhëzuesve/guidave të Kosovës individualisht, pa ndihmën ose përfshirjen tonë, duke promovuar Kosovën përmes mediave sociale, kanë krijuar me sukses lidhje me aktorë të tjerë të sektorit privat dhe janë angazhuar me politikë-bërësit për të mbrojtur çështjet e turizmit .

### Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes.

Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2019 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.2.1 Numri i NVM-ve që përdorin kanale të reja dhe të përmirësuara të shitjeve		T=75 SMEs A= 14 SMEs	19%	300	18%

Në kuadër të të arriturave 2.2, **projekti ka vazhduar të lehtësojë qasjen në kanalet e reja të shitjes për NVM-të**, kryesisht në tregjet ndërkombëtare. Fokusi në vitin 2019 ka qenë kryesisht në lidhjet tregtare për tregun zviceran. Në vitin 2019, PPSE-ja ka lehtësuar lidhjet tregtare me NVM-të dhe nën-sektorët shtesë përtej MAPS (pije, pemë dhe perime të përpunuara). Ekipi ka vazhduar të monitorojë ndikimin e aktiviteteve të mbështetura në vitin 2018, ku ekspozita në Panairin Biofach ishte jashtëzakonisht e suksesshme, duke gjeneruar kontrata dhe eksporte prej mbi 1 milion € në vitin 2018 dhe mbi 1.6 milion€ në vitin 2019. Përveç kësaj, si rezultat i suksesit të këtij aktiviteti, KIESA ka vendosur ta përfshijë këtë panair në portofolion e tyre të rregullt.

PPSE-ja pret ndikim domethënës në eksport, si rezultat i aktiviteteve të vitit 2019. Katër NVM do të zbatojnë kontrata të nënshkruara për eksport në tregun zviceran. Vlera (e pritshme) e eksporteve tashmë të nënshkruara është rreth 0.5 milion€ në baza vjetore.

1. Në kuadër të intervenimit **“Mbështetje për lidhjet tregtare”**, projekti vazhdon të punojë me Triple E, me qëllim të krijimit të **partneriteteve afatgjata të eksportit në nën-sektorë të ndryshëm**, veçanërisht në shënjestrimin e produkteve me cilësi të lartë siç janë produktet organike dhe premium. Gjatë vitit 2019, aktivitetet në kuadër të këtij intervenimi kanë përfshirë vizita vijuese për blerës të mundshëm zviceranë në NVM-të e Kosovës me potencial të bashkëpunimit të biznesit dhe identifikimin e NVM-ve të reja vendore që janë të gatshme për eksport. Si rezultat i drejtpërdrejtë i aktiviteteve në këtë intervenim, deri më tani Biopartner ka nënshkruar një kontratë me Eurofruti dhe Erboristi-Lendi dhe ka pranuar të bashkëpunojë me kompaninë Peppermint International. Në të dyja rastet, NVM-të kanë marrë certifikimin BioSuisse (mbështetur gjithashtu nga PPSE-ja) si parakusht për eksport. Negociata të mëtejshme ka në mes të importuesve zviceranë dhe dy NVM-ve, nga përpunuesit e frutave dhe perimeve në Kosovë, të cilat pritet të përmbillen gjatë vitit 2019.

Për të promovuar prodhuesit dhe produktet e Kosovës në tregun e brendshëm, PPSE-ja ka lehtësuar aktivitete të tilla siç janë: shfaqja televizive “Toka Jonë”, “Festivali i gastronomisë në Prishtinë”, dhe “Ekspedita e ushqimit shqiptar”. Dy aktivitetet e fundit janë planifikuar për në muajin korrik. “Festivali i gastronomisë në Prishtinë” është organizuar nga Chester Production, me qëllim të promovimit të produkteve dhe përbërësve vendor përmes një ngjarje dy-ditore. Fondacioni kuzhinierëve të njohur shqiptar (Fondacioni RRNO) ka filluar një hulumtim tre-vjeçar mbi përbërësit dhe recetat autentike të ushqimit shqiptar, me qëllimin për të promovuar dhe “ri-shpikur” gastronominë shqiptare. PPSE-ja ka vendosur të mbështesë Fondacionin RRNO, për pjesën kosovare të ekspeditës dhe dy trajnime ditore për një grup të zgjedhur kuzhinierësh. Detaje të mëtutjeshme do të shtjellohen në raportin vjetor.

Në kuadër të kësaj të arriture, sektori i turizmit ka mbështetur aktivitete promovuese rreth segmenteve të tregut. **Dy panaire**, Panairi EMMIT në Stamboll dhe panairi ndërkombëtar në Tiranë; **një udhëtim i familjarizimit** me TURSAB (Shoqata Turke e Agjencive Turistike ); një udhëtim i familjarizimit dhe miratim nga një person i famshëm, me operatorin turistik turistik Tatilbudur dhe një aktivitet promovues me një bloger ndërkombëtar. Disa nga aktivitetet e mbështetura kanë të bëjnë me promovimin e Kosovës në tregun turk, ku ekipi sheh se ka potencial të lartë, duke marrë parasysh që turistët turq paraqesin pjesën më të lartë të turistëve në vendet përreth Kosovës. Për më tepër, ekipi është duke punuar për promovimin e Kosovës në tregjet gjermano-folëse.

Në sektorin e turizmit, 12 NVM kanë qasje të drejtpërdrejtë në kanalet e reja dhe të përmirësuara të shitjeve. Si rezultat i drejtpërdrejtë i mbështetjes së PPSE-së, janë prezantuar tre kanale të reja të shtijës - turne me biçikletë malore për tregun zviceran, turne kulturore për tregun frëngjisht-folës, turne në Kosovë për tregun turk, të gjitha këto janë prezantuar për të promovuar Kosovën jashtë vendit. Promovimi në panairët ndërkombëtarë të turizmit dhe promovimi dixhital vazhdon të jetë fitimprurës, nga rezultatet e turizmit të PPSE-së, mbi 40 NVM përfituese kanë raportuar një rritje të atribuueshme të 655 turistëve ndërkombëtarë dhe rritje të të ardhura prej 113,500€ si rezultat i drejtpërdrejtë i intervenimeve.

- Në kuadër të intervenimit **“Promovimi ndërkombëtar”**, PPSE-ja ka lehtësuar pjesëmarrjen e 12 operatorëve turistikë të Kosovës, pronarë të produkteve dhe hoteleve për të paraqitur ofertën e tyre të turizmit në Panairin ndërkombëtar të Tiranës. Si rezultat i drejtpërdrejtë, bizneset që kanë marrë pjesë në këtë panair tashmë kanë raportuar turistë të rinj që vijnë. PPSE-ja ka angazhuar kompaninë TripleE si bashkë-lehtësues për të eksploruar **tregjet gjermano-folëse** (Zvicër, Austri dhe Gjermani), me qëllim të krijimit të lidhjeve biznesore në mes të Kosovës dhe operatorëve turistikë ndërkombëtarë nga tregjet e burimit, si dhe për të promovuar ofertën turistike të Kosovës për të rritur numrin e turistëve nga këto tregje. Një turne informues është organizuar për bashkë-lehtësuesin zviceran dhe janë krijuar kontaktet fillestare me 2 operatorë turistik zviceranë, të cilët synojnë të vizitojnë Kosovën në shtator të vitit 2019. Ekipi ka mbështetur gjithashtu Ride Albania (një operator turistik zviceran që operon në rajon) për zhvillimin dhe promovimin e turneve me biçikleta malore në Kosovë për turistët zviceranë, i cili tashmë ka dhënë rezultat duke rritur numrin e turistëve të rinj që vizitojnë Kosovën. Mbështetje të mëtejshme iu është dhënë medias TRECOM, ku PPSE-së ka mbështetur operatorin turistik Breath in Travel për të promovuar ofertën, për të vizituar Kosovën në vendet frëngjisht-folëse. Kjo tashmë ka rezultuar me rritjen e turistëve të rinj që vizitojnë Kosovën nga ky kanal dhe kompania ka pranuar rezervime për në muajin shtator të vitit 2019 dhe ka nënshkruar një kontratë me një operator ndërkombëtar turistik.
- Sa i përket **tregut turk**, PPSE-ja ka mbështetur disa aktivitete me qëllim të rritjes së numrit të turistëve turq që vizitojnë Kosovën. Aktivitetet e mëposhtme janë zbatuar me mbështetjen e një bashkë-lehtësuesi:

- Pjesëmarrja e shtatë ndërmarrjeve kosovare në panairin EMMIT, Stamboll në Janar të vitit 2019, i cili ka rezultuar me krijimin e lidhjeve të reja biznesore dhe turistë të rinj që vizitojnë Kosovën.
- Marrëveshja e partneritetit me Tatilbudur, e cila ka rezultuar me promovimin e Kosovës në 7 aeroporte në Turqi, 16 qendra tregtare dhe dy supermarkete më të mëdha në Turqi. Sa i përket marrëveshjes, partneri ka organizuar gjithashtu, një turne me figura të personave të famshëm dhe gazetarë në Kosovë, me të famshmen Suzan Kardes, e cili ishte përgjegjëse për promovimin e destinacionit turistik të Kosovës përmes kanaleve të saj në mediat sociale. Si rezultat i këtij udhëtimi, Kosova është paraqitur në njërën nga gazetatat më të mëdha në Turqi, Hurriyet (në seksionin e udhëtimit të së dielës), dhe Tatilbudur ka prodhuar një video promovuese për ofertën e Kosovës.
- Udhëtimi i familjarizimit me TURSAB, ku 5 operatorë turistikë nga Turqia vizituan Kosovën dhe ecën në majat e Ballkanit, me qëllim të promovimit të turizmit të natyrës në Kosovë. Treguesit e parë të ndikimit të këtij aktiviteti përfshijnë:
  - Hapjen e turneut në Kosovë nga GEOS Tour në muajin shtator të vitit 2019.
  - Vizitën e operatorëve turistik të natyrës të Kosovës në TURSAB për të paraqitur ofertën e tyre deri në fund të muajit shtator.
  - Informacionet turistike me operatorin turistik Jolly, për të shqyrtuar mundësinë e zgjatjes së qëndrimit të vizitorëve në Prishtinë nga vizitorë tranzit në të paktën një natë.

### Të arriturat 2.3: Palët e interesuara kanë përmirësuar organizimin e sektorit dhe rrjetëzimin.

O Të arriturat 2.3: Palët e interesuara kanë përmirësuar organizimin e sektorit dhe rrjetëzimin	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	2019 (T=Targeti, A=Arritur)	% shtesë e arritur në vitin 2018	Fundi i fazës 2021	% komulative e arritur në këtë fazë
	OP 2.3 Numri i iniciativave të përbashkëta për përmirësimin e rrjetëzimit dhe organizimin e sektorit rreth temave të përzgjedhura: menaxhimi i mbeturinave, segmentet e tregut, promovimi, koordinimi dhe shkëmbimi i njohurive	0	T=3 A= 1	33%	10	40%

Në vitin 2019, PPSE-ja ka kryer një vlerësim që synon të mbështesë organizimin e sektorit në tema që lidhen me skemat e subvencioneve dhe ndikimin në bujqësi si dhe në përpunimin e ushqimit. Kjo temë është shfaqur pas konsultimeve me shoqatat e sektorit dhe është shumë e rëndësishme duke marrë parasysh ndryshimin dhe efikasitetin e modelit të subvencioneve të aplikuar në Kosovë vs. vendet e rajonit. Për më tepër, PPSE-ja ka mbështetur çështjet e koordinimit të sektorit përmes intervenimeve dhe aktiviteteve në kuadër të të arriturave të tjera.

- PPSE-ja ka mbështetur një vlerësim hulmtues mbi "*Skemën e ndihmës bujqësore në Kosovë*". Modelet aktuale të subvencioneve në Kosovë vlerësohen si nën-optimale nga shumë aktorë të tregut. Si pjesë e hulmtimit, është organizuar një punëtori me shoqata të sektorit dhe zyrtarë

publik, për të validuar të gjeturat nga kërkimet sekondare dhe primare. Raporti përfundimtar është përgatitur dhe është ndarë me të gjithë aktorët përkatës, ku janë elaboruar rekomandime për ndryshime specifike për të përmirësuar skemat e subvencioneve dhe granteve.

Nga të arriturat e tjera, aktivitetet e mbështetura të koordinimit, janë realizuar me shoqatat e sektorit Organika dhe SHTIB. PPSE-ja ka mbështetur shoqatën Organika për të forcuar shërbimin e saj të certifikimit për anëtarët e saj përmes ngritjes së kapaciteteve (në lidhje me certifikimin organik) të stafit të saj. Për më tepër, zbatimi i intervenimit të certifikimit me këtë shoqatë ka treguar shenja suksesi drejt qëndrueshmërisë dhe rritjes së shoqatës. PPSE-ja ka mbështetur SHTIB për të kryer një vlerësim fillestar të sektorit të inputeve bujqësore në Kosovë dhe për të organizuar dy tryeza të rrumbullakëta me palët e interesuara (shitësit e lëndës së parë, MBPZHR, FVA) për tema të tilla si regjistrimi i produkteve, kontrolli i importit etj. Për më tepër, SHTIB ka organizuar një vizitë në Shqipëri për 12 anëtarë të bordit me qëllim të shkëmbimit të njohurive.

Në sektorin e turizmit, PPSE-ja ka lehtësuar aktivitetet e **koordinimit të sektorit** në kuadër të kësaj të arriture, me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e koordinimit në mes të sektorit publik dhe atij privat dhe bashkëpunimit ndërmjet komunës së Prishtinës dhe të Prizrenit. Si rezultat i mbështetjes së PPSE-së, Komuna e Prizrenit ka miratuar Strategjinë e Turizmit të Prizrenit në korrik të vitit 2019.

Përmes memorandumit të mirëkuptimit me **Komunën e Prishtinës**, Komuna ka iniciuar procesin e miratimit të një modeli të qëndrueshëm për funksionimin e pikës/qendrës informative për turizëm. Janë ndërmarrë hapa fillestarë nga komuna për hapjen e vendit të lirë të punës për zyrtar/e të turizmit; zgjerimin e pikave të informacionit për turizëm rreth qytetit dhe dixhitalizimin e pikës informative duke krijuar brendin/markën Prishtinë dhe krijimin e webfaqes. Si aktivitet paraprak, **Komuna e Prizrenit** ka përsëritur modelin e Komunës së Prishtinës për hartimin dhe miratimin (në Asamblenë Komonale) të Statutit të Muzeut të Prizrenit dhe rregulloren për të ardhurat vetanake nga burimet e atraksioneve kulturore, si dy dokumente themelore që ofrojnë një model për muzetë ekzistues dhe muzetë e rinj të themeluar, në kuadër të Komunës së Prizrenit për funksionim dhe ripërdorim më të mirë. Për më tepër, Strategjia e Turizmit e Prizrenit, e cila është hartuar me mbështetjen e PPSE-së, është aprovuar nga Kuvendi Komunal.

Sa i përket **zvogëlimit/ndalimit të përdorimit të qeseve plastike**, PPSE-ja ka ndarë të gjeturat preliminare mbi vlerësimin me MMPH-në. Të gjeturat paraqesin tre modalitete kryesore për të ecur përpara, siç janë: taksa mbi qeset plastike, zëvendësimi i qeseve jo bio-degraduese, ndalimi i qeseve plastike. Si aktivitetet pasues, MMPH-ja ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me aktorë të ndryshëm publik dhe privat për të diskutuar modalitetet më të mira për prezantimin e një modeli të përshtatshëm për ndalimin e qeseve plastike. Vendimi për ndryshim të politikave për të adresuar përdorimin e qeseve plastike pritet të bëhet në të ardhmen e afërt.

### 3.4. Fondi i mundësive

Në vitin 2019, Fondi i Mundësisë (ang. Opportunity Fund - OF) ka vazhduar të përdoret si një instrument shtesë për sektorët. Pasi që të gjitha marrëveshjet e bashkë-investimit për vitin 2018 ishin në sektorin e FNI-së, në gjysmën e parë të vitit 2019 përparësi i është dhënë intervenimeve të OF-së në sektorin e turizmit, me fokus në zhvillimin e produktit turistik. Ekipi ka bërë përpjekje të mëdha për të promovuar zhvillimin e produkteve të turizmit përmes afrimit të bizneseve me Komunën e Prishtinës dhe të Prizrenit. Në fillim të vitit 2019, është lansuar një thirrje për propozim, për zhvillimin e produkteve të turizmit në Prishtinë dhe rrethinat e saj. Nga gjithsej gjashtë aplikime, katër prej tyre janë ftuar të paraqesin idetë e

tyre konceptuale. Sidoqoftë, vetëm një nga aplikuesit është konsideruar me më shumë potencial për të zhvilluar një model të qëndrueshëm biznesi.

Deri në këtë periudhë raportimi, 4 aplikues kanë pasur mundësinë për të zhvilluar koncept dokumentin dhe një marrëveshje bashkë-investimi është nënshkruar sipas buxhetit të planifikuar për vitin 2019. Tabela më poshtë tregon detajet për marrëveshjen e bashkë-investimit për vitin 2019. Meqenëse intervenimet e OF-së janë të integruara në sektorë, të gjitha rezultatet e OF-së janë raportuar sipas sektorëve dhe të arriturave respektive të projekteve.

#	Biznesi	Vendi	Titulli i projektit	Investimi i PPSE-së	Investimi i kompanisë	Investimi në total
1	VIER PFOTEN Kosova	Prishtinë	Zonë me shtigje për ecje në natyrë dhe një park rekreativ	€ 35,000	€35,000	€70,000
<b>Investimi në total</b>				<b>€35,000</b>	<b>€ 35,000</b>	<b>€ 70,000</b>
<b>Përqindja</b>				<b>50%</b>	<b>50%</b>	<b>100%</b>

Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkë-investimi është të krijojë zonë me shtigje për ecje në natyrë (*me gjatësi maksimale 400 metra dhe gjerësi 4 metra*) dhe një park rekreativ në Pyllin e arinjve në Prishtinë, si mundësi rekreative publike shumë sezonale. Marrëveshja është nënshkruar me VIER PFOTEN Kosova me lokacion në komunën e Prishtinës. Kjo do të përmirësojë ofertën aktuale të turizmit duke zhvilluar produkte të reja (të vetme të këtij lloji në vend) duke ofruar argëtim dhe aktivitete rekreative, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e numrit të vizitorëve/turistëve të cilat nga ana tjetër do të krijojnë vende të reja pune dhe të ardhura shtesë. Për më tepër, projekti do të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit për mbrojtjen e mjedisit, duke e bërë atë të qëndrueshëm në aspektin ekonomik e social.

Janë katër aplikime të tjera të plota në rradhë: Zipline (2 rrëshqitje paralele) nga Proton Cable në Prizren; Produkte rekreative dhe argëtuese në Shtupeq nga Camping LLC; dhe azhurnimin e makinerive të përpunimit për prezantimin e produkteve të reja (role dhe shufrat e prodhuara nga frutat e thata) nga Kodra e Diellit në Gjilan.

Së fundi, ekipi ka ndjekur nga afër zbatimin e marrëveshjeve të bashkë-investimit të nënshkruara në vitin 2018:

- **Produktet Natyrale i Kosovës (PNK)** kanë përfunduar me sukses zbatimin e projektit deri në mes të muajit dhjetor të vitit të kaluar.
- **Kompania AGROBORA** ka përfunduar me sukses projektin me një mbështetje të madhe nga një konsulent i angazhuar. Zbatimi i projektit ka qenë më i ngadaltë nga sa pritej, për shkak të njohurive të kufizuara për ndërtimin dhe mobilimin e një fidanishteje moderne të specializuar. Ceremonia e inaugurimit është organizuar më 21 qershor të vitit 2019.
- Partneri i tretë, **Peppermint International** ka përfunduar pothuajse aktivitetet e projektit. Rezultatet e para nga ky investim priten në fund të sezonit.

### 3.5. Fondi për përfshirjen sociale (ang. Social Inclusion Fund)

Buxheti i përgjithshëm i SIF për vitin 2019 është 68,000 €, ndërsa gjatë periudhës raportuese buxheti i zotuar dhe i shpenzuar është 43,500 €. Në gjysmën e parë të vitit, janë nënshkruar tre marrëveshje me partnerë minoritarë, prej të cilëve dy janë biznese dhe një është OJQ.

Marrëveshja e parë është bërë me kompaninë PTU Lazareks - një kompani prodhuese për bio-pelet, e nënshkruar në dhjetor të vitit 2018 dhe është ekzekutuar gjatë periudhës së raportimit. Në kuadër të këtij partneriteti, partneri ka investuar në një objekt të ri, ndërsa PPSE-ja ka financuar blerjen e një tharëse të re për bio-pelet. Ky partneritet pritet të gjenerojë 3 punë me orar të plotë shtesë dhe të rrisë të ardhurat e më shumë se 50 përfituesve.

Marrëveshja e dytë është bërë me partnerin e OJQ-ve (NRAEWOK), ku përfshihet identifikimi dhe trajnimi i bizneseve në pronësi të grave rome, egjiptiane dhe ashkali në pesë rajone, nga të cilat tre biznese do të zgjedhën për mbështetje të mëtejshme përmes granteve të vogla SIF (deri në 3,000 €). Marrëveshja e tretë është me TP N&N Komerc, një biznes që prodhon biskota me mjaltë "Pasha". Ky partneritet synon të rrisë prodhimin dhe pjesëmarrjen në treg, duke investuar në linjë të re prodhimi për tre produkte të reja që do të prezantohen në tregun e Kosovës. Kjo do të krijojë 6 vende të reja pune shtesë (prej tyre 5 janë gra) në objekt dhe do të trefishojë vëllimin aktual të prodhimit. PPSE-ja do të mbështesë më tej kompaninë me shërbime të marketingut.

#	Partneri	Vendi	Titulli i projektit	Investimi PPSE-së	Investimi kompanisë	Investimi total
1	PTU Lazareks	Novoberdë	Mundësimi i procesit të prodhimit të bio-peletit	€ 14,500	€41,000	€ 55,500
2	TP N&N Komerc	Dobrotin	Prezantimi i linjës së re të prodhimit dhe produkteve të reja	€13,000	€ 13,500	€26,500
3	OJQ NRAEËOK	Prishtinë	Evidentimi i bizneseve në pronësi të grave rome, ashkali dhe egjiptiane	€ 7,000	/	€ 7,000
3.1.	OJQ NRAEËOK - SIF 3 grante të vogla	Kosovë	Bizneset e zgjedhura në pronësi të grave rome, ashkali dhe egjiptiane	€ 9,000	/	€ 9,000
<b>Investimi në total</b>				<b>€43,500</b>	<b>€ 54,500</b>	<b>€ 98,000</b>
<b>Përqindja</b>				<b>44%</b>	<b>56%</b>	<b>100%</b>

## 4. Temat transversale

### 4.1. Përfshirja Sociale

#### **FNI**

Në kuadër të sektorit të FNI-së dhe në kuadër të intervenimit për fuqizimin e bujqësisë së kontraktuar, PPSE-ja ka bërë partneritet me Nektar, një biznes turk në pronësi të pakicave. Nektar është një kompani përpunuese, e përqendruar në tranguj turshi dhe fermerët e kontraktuar janë nga komuniteti turk. Ekipi është duke shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit me një partner tjetër të mundshëm, prodhues të lëngjeve, nga Shtërpca për të zgjeruar prodhimin dhe për të prezantuar linjën e re të prodhimit dhe produktet e reja.

Ekipi ka bashkëpunuar kompanitë Peppermint International dhe Scardus d.o.o. për promovimin e lidhjeve të reja të tregut për eksport në tregun zviceran (në kuadër të intervenimit për lidhjet tregtare). Të dy kompanitë treguan potencial të madh në lidhjen e marrëveshjeve të eksportit me partnerë zviceranë, kështu që PPSE-ja ka mbështetur kompanitë gjithashtu me certifikim BioSuisse - që ishte një parakusht nga pala zvicerane. Kompania Peppermint International, tashmë ka nënshkruar një marrëveshje me kompaninë e njohur zvicerane (Erboristi-Lendi) për eksportimin e vajrave esencialë dhe produkteve të rignonit të egër.

Në kuadër të projektit, aktualisht është duke u hartuar një intervenim për fermerët kryesorë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, për prodhimin e MAP-ve dhe lidhjen me kompanitë përpunuese si dhe qendrat e grumbullimit. Një listë e fermerëve të interesuar, që kanë tokë të mjaftueshme dhe përvojë në prodhimin bujqësor është hartuar tashmë. Aktivitetet për t'i lidhur këta fermerë me qendrat e mbledhjes së MAP-ve dhe për të filluar zbatimin e bujqësisë së kontraktuar janë planifikuar për në muajin gusht të vitit 2019.

#### **Turizmi**

Gjatë periudhës raportuese, ekipi është duke e shqyrtuar mundësinë për përfshirje kryesisht rreth intervenimit në zhvillimin e produkteve. Në Graçanicë, është duke u përgatitur një partneritet për zhvillimin e një parku me tematikë mesjetare.

### 4.2. Gjinia

#### **Përfshirja e grave në kuadër të intervenimeve të FNI-së**

Në sektorin e FNI-së, përveç punësimit që i atribuohet grave, i cili vlerësohet rreth 40%, synohen aktivitetet e mëposhtme për integrim të përgjithshëm:

- Partneritetet me 2 NVM në pronësi të grave (NP Castrioti dhe ADE Group) në lidhje me zhvillimin e produkteve dhe intervenimet në bujqësi kontraktuese.
- Në kuadër të intervenimit për program të certifikimit organik, nga 31 NVM që janë pjesë e programit, 2 janë pronë e grave (99 Lule dhe BioFruti).

Përveç përpjekjeve të vazhdueshme të ekipit për të siguruar integrim gjinor nga intervenimet dhe aktivitetet, ndërhyrje specifike me gratë në fokus, janë duke u hulumtuar më tej për këtë vit. Në kuadër të intervenimit për zhvillimin e produkteve përmes CEED për teknologjinë ushqimore, trajnimi për prodhuesit e ëmbëlsirave tradicionale është duke u planifikuar për zbatim të mundshëm.



### ***Përfshirja e grave në intervenimet për turizëm***

Deri në periudhën e raportimit, në sektorin e turizmit, angazhimi i grave ka qenë përmes ndërhyrjes në profesione të specializuara të turizmit. Janë trajnuar dymbëdhjetë udhëzues/guida të qytetit që flasin frëngjisht, nga të cilët 6 janë gra. Trajnimet e udhëzuesve/guidave malore dhe trajnimet për çiklizëm në Prishtinë, Pejë dhe Prizren janë në proces të zhvillimit, duke synuar së paku 50% pjesëmarrëse gra. Përveç kësaj, trajnimi afatshkurtër i përshtatshëm për gratë kamariere është në proces të hartimit. Për më tepër, ekipi i turizmit ka zbatuar aktivitetet e mëposhtme:

- Njëpërmjet Fondit të Mundësive, në mesin e bizneseve të mundshme që do të financohen nga projekti për zhvillimin e produkteve turistike, një biznes është në pronësi të një gruaje, përkatësisht Eco Alpina, i cili planifikon zhvillimin e produkteve rekreative dhe argëtuese pranë lumit në Shtupeq.

Për më tepër, përmes **intervenimit SIF**, të zbatuar nga Rrjeti i Organizatës së Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës (NRAEWOK), janë organizuar katër takime informuese në katër rajone të synuara (Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Prishtinë), ku 57 gra rome, ashkali dhe egjiptiane kanë qenë pjesëmarrëse. Takimet informuese janë pasuar me nga tetë ditë trajnim për aftësi të biznesit, ku 43 grave u janë ndarë certifikata. Përzgjedhja përfundimtare për tre grantet e vogla nga intervenimi SIF (deri në 3,000 €) do të vijojë duke u bazuar në rastet studimore të paraqitura si dhe në qëndrueshmërinë e modelit të biznesit.

#### **4.2.1. Monitorimi dhe Matja e Rezultateve**

Pas vendimit për të planifikuar për një auditim të plotë DCED, përpjekjet e ekipit të MRM-së kanë qenë kryesisht të fokusuar rreth përgatitjeve për një auditim të tillë. Kjo detyrë kërkon azhurnimin e të gjithë dokumenteve të MRM-së që nga fillimi i fazës II. Ekipi ka vendosur të auditojë nëntë ndërhyrje nga të dy sektorët (pesë për FNI dhe katër për turizmin). Dokumentacioni i gjerë për çdo ndërhyrje përfshin shënime konceptuale, zinxhirë rezultatesh, plane monitorimi, plane ndërhyrje dhe vlerësime të ndikimit.

Për të matur dhe vërtetuar rezultatet për vitin 2019, PPSE po planifikon të fillojë vlerësimet e ndikimit në tetor dhe nëntor për të gjitha ndërhyrjet, gjë që korrespondon me fundin e sezonit / ciklit si në sektorin e turizmit ashtu edhe në atë të FNI-ve. Gjatë kësaj kohe PPSE do të monitorojë aktivitetet dhe ndërhyrjet që gjithashtu filluan në 2018, për të monitoruar qëndrueshmërinë dhe rritjen eventuale të ndërhyrjeve.

Ngjashëm me vitin 2018, PPSE është duke zhvilluar studimin e turizmit nga ana e ofertës, i cili studim përfshinë të gjitha ndërmarrjet që lidhen me turizmin në tërë Kosovën. Sondazhi na mundëson të kuptojmë të ardhurat dhe ndikimin në punësim të sektorit të turizmit në të gjithë Kosovën dhe të monitorojmë ndryshimet vjetore. Gjetjet e sondazhit përdoren gjithashtu për të përcaktuar matësit e përafërt të punësimit (të përdorur në fazën I), bazuar në shpenzimet e turizmit, për vlerësimin e ndikimit që mund t'i atribuohet punësimit. Një tjetër studim i planifikuar për vitin 2019 ishte një vlerësim i ndikimit të fidanëve të prodhuar në fidanishte profesionale. Sidoqoftë, pas konsultimeve me ekspertë të fushës, ekipi vendosi të mbështetet në gjetjet ekzistuese të literaturës në mënyrë që të përcaktojë dhe pretendojë ndikimin e fidanëve të prodhuar në fidanishte profesionale duke krahasuar me fidanët e prodhuar nga fermerët me teknologji tradicionale, për perimet dhe prodhimin e MAP-it.

### 4.3. Komunikimi

"Komunikimet për zhvillim", d.m.th. për të komunikuar të dhënat dhe ndikimin, kanë qenë fjalë kyçe gjatë kësaj periudhe të raportimit. Mesazhi thelbësor i të gjitha komunikimeve theksoi kontributin e Qeverisë Zvicerane në zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës në Kosovë. Tregimet Transformuese kanë qenë mjete kryesor për të paraqitur rezultatet e arritura përmes tregimeve të "personazheve me agjensi" duke u përpjekur që të jepet mesazhi i ndryshimit përmes përvojave njerëzore, duke siguruar kontekstin dhe duke e mbajtur komunikimin e thuktë dhe të absorbueshëm për audiencën.

**Programet televizive:** PPSE ka bashkëpunuar me dy produksione vendore për të prodhuar një program televiziv lidhur me prodhuesit vendor nga sektori i bujqësisë dhe ushqimit, dhe një për produktet turistike të zhvilluara në Kosovë. Emisioni javor "Toka Jonë" transmetohet përmes televizionit Klan Kosova. Qëllimi është të shfaqim aktivitetet e ndryshme të prodhimit dhe përpunimit të bujqësisë, fidanëve dhe MAP-eve, përpunimin e ushqimit, lidhjet e tregut, eksportin e produkteve lokale dhe ekspertizën nga sektori privat. Në përgjithësi, çështjet e paraqitura demonstrojnë modelin e ndryshimit dhe potencialin për rritje dhe mbështetjen e Qeverisë Zvicerane. Deri në datën e raportimit, gjithsej 15 episode janë transmetuar. Pesë episodet e "TAG Kosova" që fokusohen në produktet e turizmit, çfarë të bëni dhe të shihni në Kosovë, dhe potencialin e brendshëm të turizmit u transmetuan përmes KTV-së. Të dy programet synojnë kryesisht audiencën vendase. PPSE dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjithashtu bashkëpunuan me Ashley Colburn Productions, SH.B.A. për të sponsorizuar episodin kosovar të emisionit me 13 episode "Përmes syve të saj", duke promovuar Kosovën si një destinacion turizmi. Ekipi i produksionit ishte në Kosovë në prill për të bërë xhirimet, dhe shfaqja pritet të fillojë transmetimin në shtator të këtij viti.

**Ngjarje:** PPSE organizoi hapjen e prodhuesit të fidanëve Agrobora, i cili mori një mbulim shumë të mirë mediatik, veçanërisht përmes programeve të dedikuara televizive. Ngjarja u zyrtarizua nga përfaqësuesit e SDC-së. PPSE ofroi këshilla dhe mbështetje për partnerët me ngjarjet e tyre, veçanërisht dukshmërinë dhe marrëdhëniet mediatike. Ekspozita shqiptare e Gastronomisë e mbështetur nga SDC u paraqit dukshëm në stacionet televizive lokale dhe u promovua në internet përmes fondacionit RRNO dhe kanaleve të PPSE-së.

**Media Sociale dhe Online:** Në periudhën raportuese, PPSE hapi një llogari në Instagram për të përdorur si një kanal shtesë për të arritur tek një audiencë tjetër. Uebfaqja e projektit dhe faqja e PPSE-së në ëbfaqen globale të Swisscontact-it u azhurnuan rregullisht.

PPSE Facebook vazhdon të jetë kanali kryesor i komunikimit online të projektit. Mbulimi total organik (numri i përdoruesve unikë, tifozeve ose jo-tifozeve, të cilët kanë parë postimet në faqe) në periudhën raportuese ishte 208,386. Postimet në faqet tona u ndanë nga faqet zyrtare në Facebook të Ambasadës së Zvicrës; Swisscontact në të gjithë botën; Grupi i partnerëve zbatues të SDC-së, si dhe faqet e partnerëve apo faqe tjera individuale.

PPSE poston rregullisht në llogarinë Twitter të projektit, llogarinë medium.com dhe llogaritë e Linkedinit të anëtarëve të ekipit dhe Swisscontact në të gjithë botën për të shpërndarë më tej lajmet e projektit.

**Publikimet dhe videot:** PPSE ka botuar si vijon: dy broshura që promovojnë udhëzues lokalë të turneve të trajnuar përmes PPSE, dhe buletinin e parë gjysmë vjetor. PPSE prodhoi dy video, një për secilin sektor: FNI dhe turizmin.

**Raportimi medial:** Në periudhën raportuese, PPSE dhe aktivitetet tona përfituese janë paraqitur dukshëm në media lokale dhe ndërkombëtare: agjencitë e lajmeve në internet; radio, TV. Shih Aneksin V ku është paraqitur një listë e rasteve kur është përmendur në media PPSE-ja, Swisscontact dhe SDC.

**Pajtueshmëria dhe dukshmëria:** të gjitha materialet e komunikimit PPSE ndjekin udhëzimet e markës dhe komunikimit të SDC-së. Gjithçka është botuar në anglisht, shqip dhe serbisht.

## 5. Mësimet e nxjerra

- Në sektorin e turizmit, investimet më të mëdha në produktet e turizmit pritet të ndërmerren nga Komunat. Tashmë është dëshmuar se komunat kanë më shumë interes, zotim dhe akordim më të madh të buxhetit për zhvillimin e produkteve të turizmit. PPSE ka mbështetur Komunat e Prizrenit, Prishtinës, Pejës dhe Gjilanit me ekspertizë teknike ndërkombëtare në zhvillimin e produkteve specifike të turizmit, ku të paktën dy produkte më të mëdha të turizmit priten në fund të vitit. Në të njëjtën kohë, ekipi ka mbështetur iniciativën e produkteve të turizmit në sektorin privat, kryesisht të niveleve më të ulëta të investimeve. Sidoqoftë, procesi i përgjithshëm i zhvillimit të produkteve të turizmit është mjaft i ngadaltë dhe kompleks, ku përfshihen shumë akterë dhe ku kërkojnë shumë leje përderisa autoritetet nuk janë gjithmonë të qartë në kërkesat e tyre. Për shembull, nisma për të ofruar paragliding në Prizren pritej të zhvillohej brenda një muaji, ndërsa zgjati rreth një vit. Kjo gjithësesi ndikon në kohën e realizimit të ndikimit dhe rezultateve.
- Për ndërhyrjet në promovimin ndërkombëtar dhe promovimin e tregut turk, PPSE ka angazhuar lehtësues ndërkombëtarë bazuar në tregjet burimore. Kjo ka qenë mjaft pozitive, duke siguruar informacionin e tregut nga segmente të synuara të tregut dhe mundësi për të arritur partnerët potencialë strategjikë për promovimin e Kosovës.
- Vëzhgimet në terren tregojnë se NVM-të dhe fermat në Kosovë kanë filluar të përballen me vështirësi në tërheqjen e punëtorëve në nivelin e pagave aktuale. Kjo është kryesisht për shkak të migrimit të lartë të punës në Kosovë gjatë vitit të fundit. Për t'iu përgjigjur këtij fenomeni, NVM-të dhe fermat po shkojnë më shumë drejt mekanizmit. Kjo prirje mund të ketë implikime edhe në objektivat e punësimit në PPSE që gjenerohen kryesisht në sektorin FNI - një sektor ku faktori punë është më intensiv.
- Në sektorin e FNI-ve, strategjia e PPSE gradualisht është drejtuar në mbështetjen e kompanive më të mëdha, kryesisht në shërbime të tilla si lehtësimin e eksportit dhe teknologjinë ushqimore, ndërsa kompanitë më të vogla janë mbështetur më shumë me modernizimin e teknologjisë për tu bërë më konkurruese.